

V E N D I M
Nr.526, datë 12.8.1996

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.224, DATË
5.4.1996 “PËR DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVO-TOKËSORE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Me propozimin e sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.224, datë 5.4.1996 “Për disa ndryshime në ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë”, pika 1, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Lagjja Qendër-Sauk e fshatit Sauk dhe Lagjja e Re e fshatit Mjull-Bathore të komunës së Saukut, kalojnë në juridiksionin e Bashkisë së Tiranës, në përbërje të lagjeve ekzistuese”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi